



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DUKAGJINIA/JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot.	1-155/10946
Një Qip	2
Nr. I laq	
Data	10/12/2024

Për: Autoritetit Kontraktues - Komuna e Junikut
Lënda: Kërkesë për Informacion mbi Kualifikimet e Anëtarëve të Komisionit Vlerësues për
Projektin: Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale me nr të Prokurimit: 636-4-11356-2-2-1

Data: 10.12.2024

Kërkesë për Informacion

I nderuar/a,

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike, kërkoj nga institucioni juaj të më ofrojë informacion në lidhje me kualifikimet shkollore dhe profesionale të anëtarëve të komisionit vlerësues për projektin [Emri i Projektit X].

Informacioni i kërkuar përfshin, por nuk kufizohet në:

- 1. Kualifikimin shkollor (niveli i arsimit dhe diploma e përfunduar).*
- 2. Përvojën profesionale në fushën përkatëse.*

Ky informacion do të shërbejë për të siguruar transparencë dhe për të vlerësuar kompetencën profesionale të komisionit që ka marrë pjesë në procesin vlerësues.

Ju falënderoj paraprakisht për bashkëpunimin dhe mbetem në pritje të përgjigjes suaj brenda afatit ligj

"Q-SHALA" SH.P.K
Drejtör: z. Qlerim Shala



Subjekti: Përgjigje ndaj kërkesës për informacion (Nr. protokolli 1-155/10946, datë 10/12/2024)

Prokurimi Junik

Tue 12/17/2024 7:52 AM

To: qlerimshala1@gmail.com <qlerimshala1@gmail.com>;

Cc: Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>; Ruzhdi Shahu <Ruzhdi.Shahu@rks-gov.net>;

I nderuar,
Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion të datës 10/12/2024, me nr. protokolli 1-155/10946, ku kërkonti informacion për pikat e mëposhtme:

1. Kualifikimi shkollor
2. Përvoja profesionale në fushën përkatëse

Dëshirojmë t'ju njoftojmë se, si Zyrë e Prokurimit, Komuna Junik, nuk jemi kompetentë për t'ju dhënë qasje në dokumentet konfidenciale të anëtarëve të personelit të Komunës Junik, përfshirë edhe informacionet lidhur me kualifikimet dhe përvojën profesionale të tyre. Këto dokumente janë të mbrojtura nga dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nga rregullat e brendshme të administratës publike.

Për këtë arsye, ne nuk mund të ofrojmë përgjigje në lidhje me kërkesën tuaj për informacion.
Ju falenderojmë për mirëkuptimin dhe mbetemi të gatshëm për çdo sqarim tjetër që mund të keni.

Me respekt,

Me respekt:


Zyra e Prokurimit

Komuna Junik

Tel: 0390-370-616

Email: prokurimi-junik@rks-gov.net

P-17.





Për: Komuna e Junikut
Zyra e Prokurimit
Data: 10.12.2024

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVIA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIKUT/MUNICIPALITY OF JUNIK	
01/Nr. Prot	1-155/10847
Nje. Org	
Nr. ifaq	12/12/2024
Data	

12-16

Kërkesë për Qasje ne Dokumente

Kërkojmë nga organi i lartë cekur zyra e prokurimit Komuna e Junikut, që në bazë të **Nenit 10, pika 3 dhe pika 5**, të na lejohet qasje e pa kushtezuar në dokumentet e operatorit ekonomik te rekomanduar për dhenie të kontrates per projektin:


Me titull: **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve lokale**

Me nr të Prokurimit: 636-24-11356-2-2-1 e nr të mbrendshëm: 636-24-048-221

Konkretisht në Dokumentet e Operatorve të rekomanduar për dheni të kontratës Grup i Operatorëve Ekonomik ARFA Group Sh.p.k & V Gaxherri Group SH.P.K.

- Raportin e Vlersimit
- Vertetimin e Atk-së – Operatorit ekonomik te rekomanduar per Dhenie te kontrates
- Çertifikaten e Gjykates Ekonomike– Operatorit ekonomik te rekomanduar per Dhenie te kontrates
- Sigurimin e Tenderit– Operatorit ekonomik te rekomanduar per Dhenie te kontrates
- Te gjitha email e komunikimit ndermjet Komunes së Junikut & ARFA Group Sh.p.k & V Gaxherri Group SH.P.K.
- Te gjith Dosjen e ngarkuar në E-prokurim te Operatorve, ARFA Group Sh.p.k & V Gaxherri Group SH.P.K.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Për	Grupi i Operatorve Ekonomik VB.TOFAJ" SH.P.K & "MIVA CONSTRUCTION" SH.P.K & "ELK GROUP" SH.P.K & "DACHGroup" SH.P.K
Nga	Egronit Gaxherri – UD. Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Lënda	Përgjigje ndaj kërkesës për qasje në dokumente publike
Datë	10.12.2024

I nderuar,

Në lidhje me kërkesën tuaj për qasje në dokumente publike, e parashtruar në bazë të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ju njoftojmë si vijon:

Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj për dokumentet që lidhen me aktivitetin e Prokurimit me titull: **"Ndërtimi i sheshit të Qendrës së Komunës së Junikut (Blerja e gurëve natyral – Faza e parë)"**, Nr. i Prokurimit: **636-24-11400-1-2-1** dhe **636-24-053-121**, kemi bashkangjitur me këtë shkresë të gjithë dokumentacionin që është pjesë e komunikimit tonë me Zyrtarin Kryesor Financiar (ZKF) dhe Zyrtarin Kryesor Administrativ (ZKA), i cili përmban informacion mbi disponueshmërinë e fondeve për këtë aktivitet.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, kjo përgjigje shërben si pjesë e përmbushjes së së drejtës suaj për qasje në dokumente publike. Nëse keni nevojë për informacione shtesë apo qartësime, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni.


Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E NISHTËS NA JUNIT/KOMUNITATI I JUNIT
UJ/NR 5107
Nje 172
Nr 172
Data
02/12/2024

DORËZUAR NGA:
FERAT TOFAJ
DREJTORI V.B TOFEAT SH.P.K SHIRK
[Signature]
SHIRK. TOFEAT
SHIRK. TOFEAT
SHIRK. TOFEAT



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUIK - OPŠTINA JUIK - MUNICIPALITY OF JUIK



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

P. 14

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE

2022- 2024

JUIK, 2021

Kërkesë për të dhëna mbi buxhetin komunal dhe integrimin gjinor

Të nderuar,

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA	
REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JINIK/OPŠTINA JINIK/MUNICIPALITY OF JINIK	
01/Nr. Prot	1-155/9872
Një. Org	3
Nr i faq	3
Data	04/11/2024

Shpresoj që ky mesazh t'ju gjejë mirë. Po ju kontaktoj në emër të projektit për Decentralizim dhe Mbështetje të Komunave (DEMOS), për të cilin aktualisht jemi duke e përgatitur një studim mbi barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale në qeverisjen lokale, konkretisht në 13 komuna.

Analiza jonë synon të kuptojë praktikat aktuale në lidhje me pjesëmarrjen e grave në proceset e qeverisjes, buxhetimit dhe vendimmarrjes, duke shfrytëzuar të dhëna dytësore dhe parësore. Komunitetet e përfshira në këtë studim janë si më poshtë:

1. Kamenicë
2. Viti
3. Kaçanik
4. Suharekë
5. Prizren
6. Rahovec
7. Drenas
8. Obiliq
9. Pejë
10. Ferizaj
11. Dragash
12. Junik
13. Graçanicë

K-14

Si konsulente e jashtme e DEMOS-it, kërkoj ndihmën tuaj në sigurimin e të dhënave në lidhje me buxhetin e komunës tuaj dhe nismat për barazi gjinore. Unë kam kontaktuar tashmë me disa zyrtarë të barazisë gjinore dhe jam duke zhvilluar intervista me ta. Përveç kësaj, unë jam duke vizituar e shqyrtuar uebfaqet e komunave; megjithatë, disa informata kritike nuk janë të disponueshme online në të gjitha komunitetet e interesit. Prandaj, po krijoj këtë kërkesë për të thjeshtuar procesin e mbledhjes së të dhënave.

Vështrimet e komunës suaj janë tejet të rëndësishme për suksesin e këtij projekti kërkimor. Ne jemi veçanërisht të interesuar të kuptojmë se si bëhet integrimi gjinor në proceset tuaja të buxhetimit dhe planifikimit.

Andaj, kërkojmë të dhënat e mëposhtme:


Të dhënat financiare:

- Qarkoret buxhetore për vitet 2022, 2023 dhe 2024
- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitet 2022, 2023 dhe 2024
- Raportet Financiare për vitet 2022, 2023 dhe 2024
- Ndarjet buxhetore specifike për programe dhe projekte të lidhura me barazinë gjinore (nëse ka të tilla)
- Të dhëna për ndarjen e subvencioneve, të kategorizuara sipas gjinisë dhe qëllimit të subvencionit për vitet 2022, 2023 dhe 2024

FW: Kërkesë për qasje në dokumente publike/Zahtev za pristup javnim dokumentima

Rrustem Pepshi

Wed 10/30/2024 11:17 AM



To: Besart Zhuja <besart@institutigap.org>;

Cc: Ruzhdi Shehu <Ruzhdi.Shehu@rks-gov.net>; Zeqe Hebibi <Zeqe.Hebibi@rks-gov.net>; liberta hoxha <liberta.f.hoxha@rks-gov.net>; Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>; Arton K. Krasniqi <arton.k.krasniqi@rks-gov.net>;

1 attachments (13 KB)

21102024_Të dhënat gjinore të punësimit_shembull_Instituti GAP.xlsx;

I nderuar,

Ashtu siç biseduam në telefon, Komuna e Junikut nuk ka ndërmarrje publike. Jemi në fazën e përgatitjeve për krijimin e ndërmarrjes publike, mirëpo ende jemi në fazën fillestare.

Ju falënderojmë dhe jemi gjithmonë të hapur për bashkëpunim.

Me respekt,
Rrustem Pepshi
Zyra për informim

From: Arton K. Krasniqi <arton.k.krasniqi@rks-gov.net>

Sent: Wednesday, October 30, 2024 1:30 PM

To: Rrustem Pepshi <rrustem.pepshi@rks-gov.net>

Subject: FW: Kërkesë për qasje në dokumente publike/Zahtev za pristup javnim dokumentima

From: Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>

Sent: Wednesday, October 23, 2024 8:40 AM

To: Ruzhdi Shehu <Ruzhdi.Shehu@rks-gov.net>; Leonora.M.Shehu <leonora.m.shehu@rks-gov.net>; Arton K. Krasniqi <arton.k.krasniqi@rks-gov.net>

Cc: ariola.krasniqi@rks-gov.net

Subject: Fw: Kërkesë për qasje në dokumente publike/Zahtev za pristup javnim dokumentima

From: Besart Zhuja <besart@institutigap.org>

Sent: Monday, October 21, 2024 8:58 AM

Subject: Kërkesë për qasje në dokumente publike/Zahtev za pristup javnim dokumentima

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Kërkesë për qasje në dokumente publike/Zahtev za pristup javnim dokumentima

Besart Zhuja <besart@institutigap.org>

Mon 10/21/2024 8:58 AM

1 attachments (13 KB)

21102024_Të dhënat gjinore të punësimit_shembull_Instituti GAP.mkx;

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA JUNK/OPŠTINA JUNK/MUNICIPALITY OF JUNK	
01/Nr. Prot.	7-155/9621
Një. Org	1
Nr. i faq	2
Data	23/10/2024

K. 13

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Të nderuar zyrtarë,

Uroj që jeni mirë me shëndet.

Jemi duke e studiuar çështjen e barazisë gjinore nëpër ndërmarrjet publike dhe na nevojitet ndihma juaj.

Nëpër raportet vjetore të NP-ve rrallë herë po paraqiten të dhënat e punësimit në bazë të gjinisë të ndara në kategori të punësimit. Për shembull, të punësuar në administratë: Gra/Burra, të punësuar në prodhim/shërbime: Gra/Burra, në menaxhment: Gra/Burra, në Bord: Gra/Burra, etj.

Biles, tek kompanitë rajonale të ujit, dhe ato të mbeturinave, e kemi një problem të theksuar të përfaqësimit gjinorë. P.sh. në disa prej tyre bordet përbëhen vetëm nga burrat, gjë që përbën shkelje të dispozitave të ligjit për barazi gjinore, dhe kjo po u nxjerrë telashe edhe në ARBK me procesim të disa të dhënave.

Andaj, a ka mundësi të na siguronit të ndara nëpër kategori të dhënat e punësimit si më poshtë për ndërmarrjet lokale në komunën tuaj:

- numri (dhe %) i të punësuarve sipas gjinisë - të dhënat e përgjithshme;
- në administratë sipas gjinisë;
- në pjesën operative/prodhim (punëtoret e terrenit, etj) sipas gjinisë;
- anëtarët e bordit sipas gjinisë;
- anëtarët e menaxhmentit sipas gjinisë dhe pozitës;
- në shkollim sipas gjinisë;
- në paga sipas pozitës dhe gjinisë;
- aplikimet për pozita të ndryshme në ndërmarrje sipas gjinisë. P.sh. për x pozita kanë aplikuar x burra, dhe x gra;

Të gjitha të dhënat nëse ka mundësi për tre vitet e fundit: 2021-2023

Gjithashtu, nëse keni ndonjë raport ose udhëzues të brendshëm mbi zbatimin e kapitullit 10 "Standardet për të drejtat e njeriut", Mundësitë e barabarta të punësimit të vendosura në kodin e etikës, do t'ju luteshim që ta ndanit me ne.

Për ta bërë më të lehtë, ndoshta tabela e bashkëngjitur në këtë email shërben që me i strukturo të dhënat sipas kërkesës.

Nëse keni nevojë për ndonjë sqarim shtesë, ju lutem më shkruani.

Faleminderit paraprakisht,

Poštovani zvaničnici,

Nadam se da ste dobrog zdravlja.

Proučavamo pitanje rodne ravnopravnosti u javnim preduzećima i potrebna nam je vaša pomoć.


Re: Kërkesë për qasje në të dhëna publike

Bekim Salihu <bekim@institutigap.org>

Fri 10/25/2024 8:46 AM

To: Vjollca Qestaj <vjollca.qestaj@rks-gov.net>;

Cc: Ruzhdi Shehu <Ruzhdi.Shehu@rks-gov.net>; Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>;



Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Vjollca

Faleminderit shume, vetem nje detaje na duhet ketu, nga 253 mije euro qe i kane marre ne tri vite, sa prej ketyre mjeteve jane kete vit.

Bekim Salihu

Analist Politikash/Policy Analyst


Instituti GAP

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati II
10000 Prishtinë

www.institutigap.org

Tel: + 381 38 609-339

+383 45 626-124



P. 12

On Fri, Oct 25, 2024 at 1:39 PM Vjollca Qestaj <vjollca.qestaj@rks-gov.net> wrote:

I nderuar,

Më poshtë gjeni informatat e kërkuara nga Komuna e Junikut.

- Vlera e mjeteve të ekzekutuara në tri vitet e fundit (përfshirë edhe këtë vit) të mjeteve financiare nga kontrata kolektive është 253,306.70€
- Shuma e mjeteve që janë ende në procedurë gjyqësore apo përmbarimore dhe që pretendohet apo rrezikohet të merren nga komuna në periudhën e ardhshme është 56,740.00€.

Ju faleminderit dhe gjithë të mirat!

Me respekt,


Kërkesë për qasje në të dhëna publike

Bekim Salihu <bekim@institutigap.org>

Sat 10/19/2024 12:13 PM

To: Ruzhdi Shehu <Ruzhdi.Shehu@rks-gov.net>; Leonora M. Shehu <leonora.m.shehu@rks-gov.net>; Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>; Arton Gaxherri <arton.gaxherri@rks-gov.net>;

Cc: Blendi Hasaj <blendi@institutigap.org>;



K. 12

Allow sender | Block sender

Caution! This message was sent from outside your organization.

Të nderuar përfaqësues të Komunës së Junikut

Pa dashur të zgjatemi, për informim, Instituti GAP planifikon që në javët në vijim të publikojë **një analizë** për të treguar **gjendjen lidhur me obligimet që kanë komunat nga kontrata kolektive** dhe cilat mund të jenë rekomandimet, masat dhe hapat që mund të ndërmerren për të tejkaluar ose shmangur pasojat e mëtejshme me të cilat po përballen ose rrezikojnë të përballen komunat.

Nisur nga kjo, presim dhe kërkojme dergimin e këtyre të dhënave:

- Vlera e mjeteve të ekzekutuara në tri vitet e fundit (përfshirë edhe këtë vit) të mjeteve financiare nga kontrata kolektive.
- Shuma e mjeteve që janë ende në procedurë gjyqësore apo përmbarimore dhe që pretendohet apo rrezikohet të merren nga komuna në periudhën e ardhshme.

Për ndonjë paqartësi, mos hezitoni të na kontaktoni.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin e mirë.

Bekim Salihu

Analist Politikash/Policy Analyst

Instituti GAP
Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati II
10000 Prishtinë
www.institutigap.org
Tel: + 381 38 609-339
+383 45 626-124



P. 11

From: Rudina Hasimja <rudina.hasimja@kcsfoundation.org>

Sent: Tuesday, September 10, 2024 12:57 PM

To: Vjollca Qestaj

Cc: Qendrim Knushi; Tesa Kabashi; Dren Puka

Subject: RE: KCSF: Kërkesë për qasje në dokumente publike - Fondet Publike për OJQ 2023

Caution! This message was sent from outside your organization.

[Allow sender](#) | [Block sender](#)

Përschendetje e nderuar,

Me këtë email konfirmoj pranimin e dokumentit.
Ju faleminderit shumë për përgjigjen e shpejtë.

Çdo të mirë,

Rudina Hasimja

Hulumtuese

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile

tel: +383 (0)38 600 633, +383 (0)38 600 644, +383 (0)49 719 653

website: www.kcsfoundation.org

adresa: Musa Tolaj, B1-Nartel Center, Lam A, H1, Kati 12, nr. 65-1, Lakrishtë, Prishtinë, Kosovë

From: Vjollca Qestaj <vjollca.qestaj@rks-gov.net>

Sent: Tuesday, September 10, 2024 1:42 PM

To: Rudina Hasimja <rudina.hasimja@kcsfoundation.org>

Cc: Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>

Subject: RE: KCSF: Kërkesë për qasje në dokumente publike - Fondet Publike për OJQ 2023

You don't often get email from vjollca.qestaj@rks-gov.net. [Learn why this is important](#)

KUJDESI! Ky email vjen nga jashtë KCSF (Kosovar Civil Society Foundation). Mos klikoni në linqe ose të hapni dokumentet e bashkangjitura në këtë email, përveç nëse e njihni dërguesin dhe e dini që përmbajtja është e sigurt.

E nderuar,

Ju lutem gjeni te bashkangjitur te plotesuar dokumentin e derguar nga ju per konfirmimin e te dhenave te raportuara nga Komuna e Junikut.

Gjithashtu ju kerkojme falje nese ka mundur te ndodhe ndonje gabim teknik ne raportimet e mehereshme.



K. M.

Nga: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Për: Komunën e Junikut

A. M. ...
T. ...
E. ...
W. ...

4 shtator, 2024

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK / OPŠTINA JUNIK / MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Nr. Prot. 1-155/83a
Një. Org. 1
Nr. i faq. 2
Data 09/09/2024

Kërkesë për informata shtesë: Mbështetja financiare publike për organizata joqeveritare në vitin 2023

Po ju shkruajmë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) si organizatë e përkushtuar për zhvillimin e shoqërisë civile. Në KCSF e përcjellim rregullisht shpërndarjen e fondeve publike për OJQ, dhe qysh prej publikimit të raportit të parë të Qeverisë rreth financimit publik për organizata joqeveritare e kemi analizuar atë, së bashku edhe me aspekte të tjera të përmbushjes së kërkesave të Rregullores MF-NR 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Po ju drejtohem i sërish me kërkesën e mëposhtme për Qasje në Dokumente Publike për të verifikuar informatat nga Platforma Online si dhe Raporti i ZQM për mbështetje financiare të OJQ-ve nga institucioni juaj. Për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave për fondet publike për OJQ-të për vitin 2023, është e nevojshme të verifikojmë numrat e raportuar nga institucionet që kanë dhënë mbështetje financiare, duke ju ofruar mundësinë për të korrigjuar apo sqaruar çdo pasaktësi eventuale në procesin e raportimit.

Për këtë arsye, ju drejtohem i me kërkesën e mëposhtme e cila është hartuar në përputhje me standardet e gjasjes në informata publike, siç përcaktohet në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në dokumente publike, Neni 10. Për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave, po e ndajmë me ju një formular të hartuar, ku mund të plotësoni pjesët e kërkuara.

Ju falenderojmë paraprakisht për kohën dhe përkushtimin tuaj në sigurimin e këtyre të dhënave. Këto informata do të na ndihmojnë në hartimin e analizës për financimin publik të OJQ-ve në vitin 2023 dhe në kuptimin më të mirë të transparencës dhe llogaridhënies në financimin publik të OJQ-ve në Kosovë.

Në qoftë se keni ndonjë pyetje shtesë ose nevojë për sqarim, mos ngurroni të kontaktoni në numrin +383 49 719 653 apo në emailin rudina.hasimja@kcsfoundation.org. Gjithashtu, nëse do të lehtësonte punën tuaj, do të mundemi të takohemi fizikisht në zyrë tuaja sipas nevojës.

Me respekt,

Rudina Hasimja

Hulumtuese në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)


Email: rudina.hasimja@kcsfoundation.org

mob: +383 (0)49 719 653

tel: +383 (0)38 600 633, +383 (0)38 600 644



08.07.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT



Qendra Për Punë Sociale e Junikut

Raporti i Gjashtëmuorit (Janar – Qershor) 2024.

Raporti i gjashtëmuorit, Janar – Qershor 2024 për Shërbimet Sociale dhe Shërbimin e Kujdestarisë

Gjate këtij gjashtëmuori, shërbimi Social dhe shërbimi i Kujdestarisë i ka zhvilluar këto Aktivitete.

- Delikuencë e të miturve
- Besimi i fëmijëve
- Procedura të Pajtimit për çiftet bashkëshortore me probleme në bashkëshortësi
- Shkurorëzime
- Kontaktim prind- fëmijë
- Fëmijë me aftësi të kufizuar- kërkesa për ndihme Sociale
- Caktim i kujdestarisë
- Dhunë familjare
- Martesa para moshës madhore
- Bashkim familjar
- Fëmijë nën kujdestari
- Strehim familjar
- Strehim familjar tek te afërmit
- Strehim në institut special ISSH (për persona me aftësi të kufizuar)
- Vërtetim për humbjen e shtetësisë së RKS-s
- Vërtetim për përfitimin e shtetësisë së RKS-s
- Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e veprimit.
- Këshilla për persona në nevojë
- Numri i rasteve i këtyre shërbimeve është i paraqitur më poshtë në mënyrë tabelore

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPSTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 1-155/6240
Nje. Org.
Nr. i faq.
Data 01/08/2024

Kërkesë për E Drejta e Informimit - Kërkesë për Informacion mbi Numrin e Përfituesve nga Skemat Sociale

Qendrim Knushi

(No message text)

Elira Çallaki <foi+request-184-f1b014e5@dumedit.org>

Today 5:10 AM

Reply all

Today, 4:28 AM

Qendrim Knushi

You forwarded this message on 8/1/2024 5:10 AM

Label: DelFiveYOldEm (5 years) Expires: 7/31/2029 4:28 AM

Caution! This message was sent from outside your organization.

Përsëndetje,

Shpresoj që punët po ju ecin mbarë.

Përmes kësaj kërkesë për qasje në informacion publik ju lus të më dërgoni statistikën për numrin e personave që kanë përfituar nga skemat sociale të ofruara nga komuna juaj për vitin 2023.

Me respekt,
Elira Çallaki

Të lutem përdor këtë adresë të postës elektronike për të gjitha përgjigjet në këtë kërkesë:
foi+request-184-f1b014e5@dumedit.org

A është qendrim.knushi@rks-gov.net adresë e gabuar për Komuna e Junikut? Nëse po, të lutem na kontakto nëpërmjet këtij formulari:

https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=dumedit.org&u=aHR0cDovL2R1bWVkaXRILm9yZy9zcS9jaGFuZ2VfcmlVxdWVzdC9uZXc_Ym9keT1rb211bmFfZV9qdW5pa3V0&i=NjRhMjY0NDgxMGUzMmMyNmJlNDUwOQGMz&t=ZlUwdENHYjRaUzVHd2s0eklhMWtmRXlWOSs1cDFqeGJqTi9aTEh3TkWzWTQ=&h-e370343b02a842f7a432311bf1eeb767&s=AVNPUEhUT0NFTkNSWVBUSVbsd6dextUfi99MN0FNZlqpAKglUhZzg4v7aPdeW9w-rG2PIQIGOkbZ-lr03bJYx3Q

Shfajësim: Ky mesazh dhe çdo përgjigje që ti i jep atij do të publikohen në internet. Politikat tona për privatësinë dhe të drejtat autoriale:

<https://eu-central-1.protection.sophos.com?d=dumedit.org&u=aHR0cDovL2R1bWVkaXRILm9yZy9zcS9oZWxwL29mZmljZX>

RIKUJTIM: KËRESË PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

Qendrim Knushi

(No message text)

Albana Hasani <albana@levizjafol.org>

Reply all

Wed 7/31/2024 5:14 AM

Cc

Mexhide Demolli <mexhide@levizjafol.org>;

Nora Bajrami <nora@levizjafol.org>

You forwarded this message on 7/31/2024 8:15 AM

Label DelFiveYOIdEm (5 years) Expires: 7/30/2029 5:14 AM

Caution! This message was sent from outside your organization.

I nderuari Zyrtar Kryesor Administrativ / Zyrtar për Qasje në Dokumente Publike,

Bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, kërkojmë nga institucioni juaj t'i përgjigjet kërkesës së mëposhtme për qasje në informacione publike nga Lëvizja FOL, pyetje këto që gjenden në **pyetësorin e bashkangjitur**.

Lëvizja FOL, mbështetur nga CDF, është duke zbatuar projektin "*Gardianët e të Dhënave: Forcimi i Politikave të Privatësisë dhe Ndërgjegjësimit në Institucionet Publike*", përmes Human Rightivism që mbështetet nga Ambasada e Suedisë në Kosovë përmes Community Development Fund - CDF.

Në kuadër të këtij projekti, Lëvizja FOL do të realizojë hulumtimin lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në institucionet publike të Kosovës, lidhur me respektimin e obligimeve ligjore që dalin nga Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Hulumtimi ka për qëllim të identifikoj nevojat e institucioneve publike për mbrojtjen e të dhënave personale dhe i njëjti do të publikohet me informatat e siguruara nga institucionet, përfshirë rekomandimet për Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe institucionet tjera.


Pyetjet mund t'i gjeni duke klikuar në linkun e mëposhtëm:

<https://forms.office.com/e/5AKjw9jxC5>

Përgjigja në këto pyetje nuk ju merr më shumë se 5 minuta kohë, prandaj me mirëkuptim kërkojmë nga ju të përgjigjeni brenda kohës së paraparë në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Për çdo informacion shtesë, ju lutemi na kontaktoni!


Me respekt,



Today, 8:15 AM

K-9

P.G. ELEKTRONIKE
TV 7502



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/14/24
Datë: 28.06.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të ligjit për vetëqeverisje lokale (Liq. nr. 02/1-040, GZRK numër 28/2008), nenit 22 paragrafi 12.1 pika d) të Statutit të Komunës së Junikut dhe Qarkorës Buxhetore 2025/01 për Komunal, Kuvendi i Komunës së Junikut, në mbledhjen e tij të rregullit të mbajtur më datë 28.06.2024 regjerrë këtë:

VENDIM

për


miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2025/2027

- I. Me këtë vendim miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) në kuljtë preliminar të Buxhetit komunal të Komunës së Junikut për periudhën 2025/2027 e propozuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- II. Pjesë Përbërëse e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale KABK 2025/2027.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Junikut.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse përveç vetëqeverisjes lokale, si dhe publikimi në gjuhët zyrtare në web faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës;
5. Arkivi Komunal.

Kuvendi i Komunës së Junikut
Z. Shpejtim Gacafari
Kryesues



Të nderuar,

Instituti GAP në bashkëpunim me DEMOS janë duke përgaditur disa infografika për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KAB) 2025 – 2027, të cilat do të publikohen gjatë muajve në vijim. Për arsye se nuk patëm mundësi t'i gjenim në web faqen e komunës tuaj, po ju drejtohem me kërkesë.

Ju lutem që të na e përcjellni përmes email-it:

- KAB 2025 – 2027 të miratuar nga Kuvendi Komunal në qershor të këtij viti (2024).


Urojmë që kjo kërkesë të trajtohet sipas ligjit për qasje në dokumente publike.

Sinqerisht,
Instituti GAP

--
Antigona Berisha- Lucaj
Zyrtare për Komunikim/ Asistente Hulumtuese
Communications Officer/ Research Assistant

Instituti GAP
Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati II, Nr.4, Qyteza Pejton
10000 Prishtinë
www.institutigap.org
Tel: + 383 38 609-339

K-8



Tema: Kërkesë për qasje në të dhëna publike rreth programeve mbështetëse nga komunat

Nga: Nora Jusufi, Konsulente e Jashtme, Finance Think

Data: 25.04.2024

Të nderuar,

Unë quhem Nora Jusufi dhe jam një Konsulente e Jashtme që përfaqësoj Finance Think, një institut kërkimor me bazë në Maqedoninë e Veriut. Aktualisht jemi të angazhuar në një projekt gjithëpërfshirës të hartëzimit të të dhënave të ndihmës shtetërore në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, si pjesë e iniciativës "Ndihma shtetërore dhe investimet e huaja direkte në vendet e Ballkanit Perëndimor: Nxitja e transparencës dhe krijimi i hapësirës për koordinimin rajonal të politikave të investimeve", mbështetur nga **Open Society Foundation** në Maqedoni.

Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, ne kërkojmë ndihmën e institucionit tuaj për ofrimin e informatave të detajuara në lidhje me të gjitha llojet e mbështetjes, duke përfshirë grantet, subvencionet, që mund të konsidherohen ndihma 'de minimis' të ofruara për qytetarët, bizneset dhe investitorët e huaj, sipas rastit.

Llojet e programeve për të cilat kërkojmë informata janë si më poshtë:

- Programet apo Masat për dhënien e granteve/subvencioneve në kulturë, rini, sport, mirëqenie sociale, apo të tjera për vitet 2019-2023
- Programe tjera të veçanta të implementuara gjatë viteve 2019-2023
 - P.sh. Masat në kuadër të Programit për Rimëkëmbje Ekonomike
 - Program tjetër (të specifikohet)

Ne kemi zhvilluar një udhëzues të strukturuar të hartëzimi të të dhënave, për të siguruar uniformitet dhe gjithëpërfshirje në përpjekjet tona për mbledhjen e të dhënave:

Tabela e mbledhjes së të dhënave:

Ju lutemi vini re se unë kam bashkangjitur një dokument në Excel për lehtësinë tuaj, të cilën mund ta përdorni si shabllon dhe ta përshtatni sipas informatave tuaja specifike.

Dokumentet burimore:

Përndryshe, ju gjithashtu mund të dërgoni raporte ose informacione të tjera, si p.sh. linqet e uebfaqeve/dokumenteve në internet, nga të cilat unë mund të nxjerr këto informata. Ky dokument mund të plotësohet nga secila drejtori/departament përkatës dhe të dërgohen të dhënat e ndara sipas drejtorisë/departamentit.

Tabela në excel përmban kolonat e mëposhtme:

- **Programi** (p.sh. Programi për Kulturë Rini dhe Sport)
- **Sektori** (p.sh. Mbështetje për regjisorë të filmit, muzikantë, infrastrukturë të teatrit)
- **Masa** (p.sh. Masa 1 – mbështetje artistëve në kohë të COVID-19)
- **Institucioni kompetent** (p.sh. Komuna e Deçanit, Komuna e Gjakovës, secila komunë e veçantë)

RE: Kërkesë për qasje në dokumente publike: Mbështetja financiare publike për organizata joqeveritare në 2023

Vjollca Qestaj

Fri 5/3/2024 3:49 AM

To: rudina.hasimja@kcsfoundation.org <rudina.hasimja@kcsfoundation.org>;

Cc: Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>

1 attachment (713 KB)

Komuna e Junikut_Fondet Publike 2023_KCSF.docx

PG

E nderuar,

Ju lutem gjeni te plotesuar dokumentin e meposhtem me te dhenat nga Komuna e Junikut.

Ju kerkojm falje per vonesen,

Gjithe te mirat!

Me respekt,



A. Mulla Tefaj, "Bartolomej" Elbasan, 6000
Rr. 12-000-001, Prishtine, Kosovo
T. +383 49 719 653, +383 38 600 633
E. info@kcsfoundation.org
W. www.kcsfoundation.org

Nga: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Për: Komunën e Junikut

22 prill 2024

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

DI/Nr. Protokol: 1-155/3559
Nje. Org: 1
Nr. i fuq: 6
Data: 23/04/2024

Kërkesë për qasje në dokumente publike: Mbështetja financiare publike për organizata joqeveritare

Po ju shkruajmë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) si organizatë e përkushtuar në zhvillimin e shoqërisë civile. Ne në KCSF e përcjellim rregullisht shpërndarjen e fondeve publike për OJQ dhe qysh prej publikimit të raportit të parë të Qeverisë rreth financimit publik për organizata joqeveritare e kemi analizuar atë, së bashku edhe me aspekte të tjera të përmbushjes së kërkesave të Rregullores MF-NR 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Aktualisht jemi duke e përfunduar analizën e mbështetjes financiare publike për OJQ për vitin 2023. Për këtë arsye, ju drejtohem me kërkesën e mëposhtme e cila është hartuar në përputhje me standardet e qasjes në informata publike, siç përcaktohet në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në dokumente publike, Neni 10. Për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave, po e ndajmë me ju një formular të hartuar, ku mund të plotësoni pjesët e kërkuara.

Ju falenderojmë paraprakisht për kohën dhe përkushtimin tuaj në sigurimin e këtyre të dhënave. Këto informata do të na ndihmojnë në hartimin e analizës për financimin publik të OJQ-ve në vitin 2023 dhe në kuptimin më të mirë të transparencës dhe llogaridhënis në financimin publik të OJQ-ve në Kosovë.

Në qoftë se keni ndonjë pyetje shtesë ose nevojë për sqarim, mos ngurroni të kontaktoni në numrin +383 49 719 653 apo në emailin rudina.hasimja@kcsfoundation.org. Gjithashtu, nëse do të lehtësonte punën tuaj, do të mundemi të takohemi fizikisht në zyrë tuaja sipas nevojës.

Me respekt,


Rudina Hasimja

Hulumtuese në Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Email: rudina.hasimja@kcsfoundation.org

mob: +383 (0)49 719 653

tel: +383 (0)38 600 633, +383 (0)38 600 644



Për: Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Nga: Zyrën për Informim, Komuna e Junikut

Data: 22.04.2024

Përgjigje në qasje në dokumente publike

Te nderuar

Për shkak të problemeve të vazhdueshme me web faqet e kemi pasur të pamundur të ju lajmërojmë me heret për çka ju kërkojmë falje për ndonjë vonës të mundshme.

Andaj të plotësuar gjeni të dhënat e kërkuara gjithashtu krahas dokumentit të skanuar do të ju vij edhe dokumenti në word që ju mund të bëni verifikimin me lehtë.

Per çdo paqartësi mos heitoni në numrin e telefoni

Tel: +38349516900

Apo në e-mail: rustem.pepshi@rks-gov.net

Rrustem Pepshi- Zyra për informim

Pyetjet të cilat kërkojnë përgjigjen tuaj janë të paraqitura më poshtë:

Pyetja 1: A ka pasur publiku qasje në draft rregulloret Kuvendit Komunal për vitin 2023?

Përgjigjen shëno këtu si dhe bashkëngjit linkun/dëshminë:

Linku

Konsultime Publike - DOKUMENTET SHITESË PËR KONSULTIM PUBLIK

<https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2023/11/Rregullorja-per-Taksa-Ngarkesa-dhe-Gjaba-komunale-2023-Shtator-leximi-i-pare.docx>

<https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2023/04/DRAFT-JUNIK-PRR-PER-MENAXHIMIN-E-MBETURINAV.docx>

<https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2023/02/Rregullorja-per-IEA-ne-K-Junik.pdf>

<https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2023/01/Rregullorja-per-Taksa-Ngarkesa-deh-Gjaba-komunale-2023-leximi-i-pare....pdf>

Pyetja 2: A e ka thirrë KK në raportim Kryetarin në Kuvend dhe komitete gjate vitit 2023?

Përgjigjen shëno këtu si dhe bashkëngjit linkun/dëshminë:

Linku

Kuvendi - FTPSAT DHE MATERIALET PËR TAKIMET E KUVENDIT

Pika 2

<https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2023/02/mbledhjen-e-dyte-te-KK-janar-2023.pdf>

Pika e 5 Drejtoria për zhvillim ekonomik, bujqesi dhe turizem

<https://kk.rks-gov.net/junik/wp-content/uploads/sites/39/2023/04/Final.pdf>

Për: Zyrën për Informim, Komuna e Junikut

Nga: Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Data: 11/04/2024

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA JUKIK/OPŠTINA JUKIK/MUNICIPALITY OF JUKIK	
01/Nr. shtet:	1-180/3270
Nje. Org.	1
Nr. i lag.	2
Data:	12/04/2024

Kërkesë për qasje në dokumente publike

I nderuari z. Knushi,

Konsorciumi i organizatave të shoqërisë civile Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT), e udhëhequr nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe 12 organizata tjera partnere të shoqërisë civile (1. Mundësia NGO, 2. Polis, 3. AvoNet, 4. Qeliza, 5. Gjethi, 6. Center for Peace and Tolerance, 7. Center for Policies and Advocacy - QPA, 8. OJQ SHL Kosova, 9. Iniciativa Qytetare Shëndetshaj - IQS, 10. Ekovizioni, 11. NGO Fortesa, 12. Syri i Vizionit) është duke vazhduar me monitorimet e institucioneve lokale konkretisht në matjen dhe vlerësimin e indikatorëve të transparencës komunale për periudhën janar – dhjetor 2023. Si rezultati i këtij angazhimi të përbashkët, do të publikohet **“Transparometrit komunal - 2023”** i cili bazohet në 48 indikatorë vlerësues dhe do të përfshinë 38 Komunat e Republikës së Kosovës.

Me qëllim të informimit dhe validimit të disa indikatorëve vlerësues, AQT kërkon nga ana e komunës qasje në disa informata sipas të drejtës për qasje në dokumente publike. Këto informata, do t'i shfrytëzohen në funksion të marrjes së informatës dhe validimit të indikatorëve të caktuar për komunën e Juaj.

Ju lutemi që pasi t'i plotësoni përgjigjet në pyetjet e paraqitura më poshtë, të njëjtin dokument të na përcillni në e-mail: bramadanaj@kdi-kosova.org jo më larg se 02.04.2024.

Nëse keni nevojë për sqarime shtesë ju lutem mos hezitoni të na shkruani apo të na kontaktoni në numrin: 048 219 177

Pyetjet të cilat kërkojnë përgjigjen tuaj janë të paraqitura më poshtë:

<i>Pyetja 1: A ka pasur publiku qasje në draft rregulloret Kuvendit Komunal per vitin 2023?</i>
Përgjigjen shëno këtu si dhe bashkëngjit linkun/dëshminë:
<i>Pyetja 2: A e ka thirrë KK në raportim Kryetarin në Kuvend dhe komitete gjate vitit 2023?</i>
Përgjigjen shëno këtu si dhe bashkëngjit linkun/dëshminë:
<i>Pyetja 3: A e ka thirrë KK në raportim drejtorët/eshat në Kuvend dhe komitete gjate vitit 2023?</i>
Përgjigjen shëno këtu si dhe bashkëngjit linkin/dëshminë:

RE: Kërkesë për të dhëna

Vjollca Qestaj


Mon 1/22/2024 7:50 AM

To: Bletë Rashiti <bleterashiti@qika.org>;

Cc: Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>; Shpejtim Gacaferi <shpejtim.gacaferi@rks-gov.net>;

1 attachments (20 KB)

Të dhënat për paga dhe mëditje.docx;



P-4

E nderura,

Ju lutem gjeni te bashkengjitur tabelen e plotesuar me te dhenat e kerkuara nga Komuna e Junikut.

Me respekt,

Vjollca Qestaj

Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
Komuna Junik

Tel: +383 46 106 286

E-mail: vjollca.qestaj@rks-gov.net

From: Bletë Rashiti <bleterashiti@qika.org>

Sent: Friday, January 19, 2024 10:52 AM

To: Vjollca Qestaj <vjollca.qestaj@rks-gov.net>; Shpejtim Gacaferi <shpejtim.gacaferi@rks-gov.net>

Cc: Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>

Subject: Kërkesë për të dhëna

Përshëndetje,

Uroj të jeni mirë!

Po ju shkruaj nga Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion –QIKA për të ju kërkuar disa të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Organizata QIKA është duke zbatuar një projekt të mbështetur nga KFOS (Kosovo Foundation for Open Society). Përmes këtij projekti synojmë të vizualizojmë statistikën që lidhet me Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinnor, që tashmë është obligim ligjor për të gjitha institucionet e Kosovës. Disa nga të dhënat që do të vizualizojmë janë pagat dhe mëditjet

Kërkesë për të dhëna

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA JENIK / OPŠTINA JENIK / MUNICIPALITY OF JENIK	
01/No. Pril.	1-155/799
Nje. Org.	2
Nr. i Fax.	
Data	22/09/2024

Bletë Rashiti <bleterashiti@qika.org>

Fri 1/19/2024 6:57 AM

To: Vjollca Qestaj <vjollca.qestaj@rks-gov.net>; Shpejtim Gacaferi <shpejtim.gacaferi@rks-gov.net>;

Cc: Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>;

1 attachments (14 KB)

Të dhënat për paga dhe mëditje.docx;

K-4.

Përsëritje,

Uroj të jeni mirë!

Po ju shkruaj nga Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion –QIKA për të ju kërkuar disa të dhëna të ndara sipas gjinisë. Organizata QIKA është duke zbatuar një projekt të mbështetur nga KFOS (Kosovo Foundation for Open Society). Përmes këtij projekti synojmë të vizualizojmë statistikën që lidhet me Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinnor, që tashmë është obligim ligjor për të gjitha institucionet e Kosovës. Disa nga të dhënat që do të vizualizojmë janë pagat dhe mëditjet

Po ju drejtohem juve, pasi që na duhen të dhënat e ndara sipas gjinisë lidhur me numrin total të të punësuarve në komunën tuaj si dhe pagat vjetore. Për detajet specifike të kërkesës në lidhje me pikat e lartcekura, luteni të plotësoni tabelën e bashkëngjitur.

Ju lutem ndihuni të lirë të na kontaktoni për çdo pyetje apo paqartësi

Ju falënderojmë shumë për bashkëpunimin,


Cdo të mirë,
Bletë Rashiti
+383 49 388 148

Për : Qëndrim Knushi – Zyrtar përgjegjës për qasje në dokumentet Publike në Komunën e Junikut

Nga : Shemsi Jashari – OJQ Demokracia Fillon Këtu-DFK

Lënda : Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare

Data : 18.01.2023



I nderuar z. Knushi,

Bazuar në ligjin Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike kërkoj nga Zyra e Informimit të Komunës së Junikut, që të përgjigjet në pyetjet si më poshtë:

1. A është caktuar zyrtari përgjegjës për konsultim publik (nëse po, linku i vendimit)?
2. A është përfshirë planifikimi i konsultimeve publike në planin të punës së komunës për vitin kalendarik (2023) (linku i planit të konsultimeve)?
3. A është përfshirë planifikimi i konsultimeve publike në hartimin e planit për komunikim publik për vitin 2023 (linku i planit të konsultimeve publike)?
4. A ka hartuar zyrtari përgjegjës për konsultim publik plan të veçantë për të gjitha projekt-propozimet e organit propozues të akteve nënligjore dhe politikave lokale, të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik për vitin kalendarik (2023), (linku i planit)?
5. A ka listë për konsultime të grupeve të interesit (nëse po, linku i listës)?
6. A është zhvilluar ndonjë konsultim në fazat e hershme (gjatë hartimit të aktit komunal) me palët e interesuara që ndikohen apo dëshirojnë të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes (nëse po, linku i procesit)?
7. A është shpallur thirrja publike nga organi propozues për identifikimin e palëve të interesuara për përfshirje në grupet punuese, (në rast se po linku i thirrjes)?
8. A janë përfshirë palët e interesuara në grupet punuese, në rast se po (linku i vendimit)?
9. A ka pasur propozime nga grupet e jashtme punuese, iniciativa qytetare, apo komitetet konsultative, (nëse po, ju lutem bashkangjiteni linkun e konsultimit)?
10. A ka ndonjë rast, kur Kryetari komunës ka kthyer mbrapa një projekt propozimet si rezultat i mos përmbyesjes së standardeve minimale për procesin e konsultimit publik? (nëse po linkun e procesit)?
11. A ka pasur ndonjë rast, kur Kuvendi i komunës ka refuzuar aprovimin e projekt propozimeve në rastet kur të mos përmbyesjes së standardeve minimale të konsultimit publik sipas kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim administrative, (nëse po, procesverbali, apo linku i procesit)?
12. Një shembull i formularëve shpjegues të projekt-propozimit për konsultim publik dhe dokumentacionit përcjellës (linku nga ndonjë proces)?
13. A ka pasur trajnime apo ngritje të kapaciteteve për standardet minimale të konsultimit, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, apo organizatat, (nëse po, shënoni kur dhe kush e ka organizuar)?



REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRY OF INTERIOR
JUNIK
1-180/962
No. 159
Data 25/01/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/21

Datë: 25.01.2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 13, Statutit të Komunës së Junikut nenit 43, Ligji nr. 06/I-081 për qasje në dokumente publike, kërkesës nga Kallxo.com të datës 18.01.2024, me numër të protokollit 1-155/722, Kryetari i Komunës me datë: 25.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

P-2



- I. Lejohet ofrimi i qasjes në dosjen e tenderit “Ndërtimi i urës që lidh Komunën e Junikut me eko fshatrat Gjocaj dhe Jasiq” me numër të prokurimit 636-23-2977-5-2-1.
- II. Informatat të cilat merren nga dokumentacioni i kerkuar duhet të shfrytëzohen sipas legjislacionit në fuqi.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Zyra e prokurimit,
2. Pala,
3. Arkivi komunal.




kallxo



Për: Komunën e Junikut
Nga: KALLXO.com
Re: Kërkesë për qasje në dokumente publike

Data: 17 janar 2024



Përmes kësaj letre, KALLXO.com, për qëllime të hulumtimit të një teme, kërkon qasje në këto dokumente publike/informacion:

1. Procesverbalin e hapjes së ofertave
2. Raporti i ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit vlerësues
3. Emrat dhe pozitat e Komisionit të vlerësimit të ofertave
4. Emrat dhe departamenti përkatës që ka hartuar specifikat teknike

K-2

Këto dokumente i kërkojmë për tenderin "Ndërtimi i urës që lidh Komunën e Junikut me eko fshatrat Gjocaj dhe Jasiq" me numër të prokurimit 636-23-2977-5-2-1

Këtë kërkesë e bazojmë në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Në rast se dokumenti/tet në fjalë përmbajnë të dhëna personale të mbrojtura me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ju lusim që të njëjtat t'i mbulonit. Në çdo rast, ne zotohemi se ato të dhëna do t'i ruajmë dhe përdorim konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

Kopjet mund të na përcillni nëpërmjet adresës elektronike: egzondahsyla@jetanekosove.com, apo edhe përmes postës në adresën: BIRN, Mensa e Studenteve, kati i parë, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Me respekt,

Egzon Dahsyla, gazetar në BIRN/KALLXO.com.


BIRN
Ballkan Internjetojale dhe Evropiane
Rregullorja e Gazetarit

Rr. Afrim Zhitia, Nr. 7, Mensa e studentëve, kati i parë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel/fax: +383 38 22 44 98
www.kallxo.com
info@kallxo.com

RE: Informata Shtesë: Kërkesë për qasje në dokumente publike -
Mbështetja financiare publike për organizata joqeveritare në vitin 2022

Vjollca Qestaj

Tue 1/23/2024 9:49 AM

To: rudina.hasimja@kcsfoundation.org <rudina.hasimja@kcsfoundation.org>;

Cc: Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>;

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA JONIK/OPSTINA JONIK/MUNICIPALITY OF JONIK	
01/Nr. Prot.	1 130/895
Një. Org	4
Nr. i faq	
Data	23/01/2024

2 attachments (718 KB)

Kërkesë për informata nga Komuna e Jonikut 17 janar 2024_KCSF (1).docx; Informatat e kerkuara.xlsx;

E nderuar,

Ju lutem gjeni te bashkengjitur dokumentin e plotesuar me te dhenat e kerkuara nga Komuna e Jonikut.

Me respekt,

Vjollca Qestaj

Drejtore për Buxhet dhe Financa

Komuna Jonik

Tel: +383 46 106 286

E-mail: vjollca.qestaj@rks-gov.net

From: Qendrim Knushi <qendrim.knushi@rks-gov.net>

Sent: Thursday, January 18, 2024 8:42 AM

To: Vjollca Qestaj <vjollca.qestaj@rks-gov.net>

Cc: Ruzhdi Shehu <Ruzhdi.Shehu@rks-gov.net>; Leonora.M.Shehu <leonora.m.shehu@rks-gov.net>

Subject: Fw: Informata Shtesë: Kërkesë për qasje në dokumente publike - Mbështetja financiare publike për organizata joqeveritare në vitin 2022

From: Qendrim Knushi

Sent: Thursday, January 18, 2024 4:37 AM

To: Vjollca Qestaj; Ruzhdi Shehu; Leonora.M.Shehu

Subject: Fw: Informata Shtesë: Kërkesë për qasje në dokumente publike - Mbështetja financiare publike për organizata joqeveritare në vitin 2022

E nderuar znj/ Qestaj kemi pranuar ketë kërkesë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile

**KCSF**

	REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRI I BEGUTIMIT KOMUNA E JUNIKUT Nr. 1-155/2022 18/01/2024
--	--

A: Mënyrë e shprehur për të marrë informata
 B: Kërkuesi i informacionit
 C: Përgjigje e informacionit
 D: Përgjigje e informacionit
 E: Përgjigje e informacionit
 F: Përgjigje e informacionit

17 janar, 2024

Nga: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Për: Qendrim Knushi, Zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike, Komuna Junik

K-1

Kërkese për qasje në dokumente publike: Mbështetja financiare publike për organizata joqeveritare në vitin 2022

Po ju shkruajmë nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) si organizatë e përkushtuar në zhvillimin e shoqërisë civile. Ne në KCSF e përcjellim rregullisht shpërndarjen e fondeve publike për OJQ dhe qysh prej publikimit të raportit të parë të Qeverisë rreth financimit publik për organizata joqeveritare e kemi analizuar atë, së bashku edhe me aspekte të tjera të përmbushjes së kërkesave të Rregullores MF-NR 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Po ju drejtohem me kërkesën e mëposhtme për Qasje në Dokumente Publike për të verifikuar informatat nga Raporti i ZQM për mbështetje financiare të OJQ-ve nga institucioni juaj, si dhe për informatat shtesë rreth fondeve të raportuara, kjo për shkak të mosfunksionimit të platformës për financim publik të OJQ-ve, tash e tre muaj. Për këtë arsye, ju drejtohem me kërkesën e mëposhtme e cila është hartuar në përputhje me standardet e qasjes në informata publike, siç përcaktohet në Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në dokumente publike, Neni 10. Për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave, po e ndajmë me ju një formular të hartuar, ku mund të plotësoni pjesët e kërkuara.

Më saktësisht, kërkojmë informatat e mëposhtme:

- Verifikimi apo konfirmimi i mbështetjes totale të raportuar prej € 81,418.55 sipas Raportit Vjetor për Mbështetjen Financiare Publike për Organizatat Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, për vitin 2022. Kjo shumë raportohet në 1) faqen 26 të raportit, tek 4.1. Të dhënat e përgjithshme për financimin publik të OJQ-ve për vitin 2022; 2) faqet 77-78 të raportit, ku janë të listuara OJQ-të përfituese dhe shuma e dhënë, në Shtojcën 6.2. Lista e OJQ-ve përfituese dhe shuma e mbështetjes financiare publike për vitin 2022 raportuar sipas komunave në platformën për financim
- Të dhënat e detajuara të projekteve të financuara, që përfshijnë të dhënat sipas specifikimeve të Nenit 25 të Rregullores MF 04/2017 (të dhënat e disponueshme në raportin vjetor për mbështetjen financiare të OJQ-ve janë të kufizuara te paragrafët 2.1, 2.4, 2.6, dhe 2.8. Për të siguruar saktësinë e përmbajtjes së analizës, ne kërkojmë qasje në tërësinë e këtyre të dhënave në formatin Excel). Neni 25 i Rregullores MF 04/2017 cekë:

- 2.1. Emrin e ofruesit të mbështetjes financiare publike, duke përfshirë programet specifike në kuadër të të cilave ofrohet mbështetja financiare publike;
- 2.2. Mënyrën e alokimit të mbështetjes financiare publike;
- 2.3. Thirrjen publike përmes të cilës është ofruar mbështetja financiare;